



Republika e Kosovës /Republika kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Lipjanit / Opština Lipjan / Municipality of Lipjan

Në bazë të neneve 5,6,7 dhe 12 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi Nr. 15-345/02-23605 të datës 30.06.2023 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr.020/01-14204 të datës 07.04.2025, Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim shpallë:

NJOFTIM PUBLIK

Për dhënien e licencave për personat fizik dhe juridik për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me automjete taksi në Komunën e Lipjanit:

Operatorët auto taksi duhet të plotësojnë kushtet si në vijim:

- Të jenë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë të transportit të udhëtarëve me automjete taksi,
- Të kenë selinë e biznesit në territorin e Komunës së Lipjanit,
- Personat fizik të kenë në pronësi automjetin, ndërsa personat juridik të kenë në pronësi së paku 3 automjete,
- Automjeti duhet të jetë i regjistruar me 5 ulëse (4+1) dhe së paku 4 dyer (nuk pranohet homologimi ose ndryshimi i ulëseve të automjetit),
- Ngjyra e automjeteve mund të jetë e ndryshme me kusht që automjetit ti vendoset një shirit identifikues me ngjyrë bardh e zi në formë katrore duke përjashtuar automjetet që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" të cilat duhet të jenë të ngjyrosura vetëm me ngjyrën e bardhë,
- Drejtuesit e automjeteve të posedojnë patentë shoferin për kategorinë "B" dhe së paku 5 vite përvojë në drejtimin e automjetit, ndërsa të punësuarit te personi juridik edhe kontratën e punës,
- Operatorët të cilët operojnë auto taksi në qytetin e Lipjanit duhet të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se 18 vite, ndërsa operatorët të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" duhet të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se 13 vite,
- Përparësi për tu pajisur me licencë në kushte të barabarta do të kenë operatorët të cilët kanë ushtruar veprimtarinë auto taksi,
- Automjetet të cilat e bëjnë djegien me gas nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë auto taksi,
- Të posedojë taksimetrin e vendosur në automjet në gjendje të rregulltë, i bazhdaruar nga organi kompetent,
- Të ketë të vendosur mbi kabinë paralel me erëmbrojtësin tabelën me dimensione standarde e paisur për ndriçim natën me shenjën "TAXI",
- Të posedojë aparatin për fikjen e zjarrit,
- Të posedojë sistemin e ngrohjes dhe të ventilimit.

Operatorët të cilët aplikojnë për marrjen e licencës, aplikacionit duhet ti bashkangjitet dokumentacionin, si vijon:

- Certifikatën mbi regjistrimin e biznesit,
- Informatat mbi të dhënat e biznesit,

- Fotokopjen e Certifikatës së regjistrimit të automjetit,
- Për drejtuesit e automjeteve fotokopjen e patent shoferit për kategorinë “B”, ndërsa për të punësuarit edhe kopjen e kontratës së punës,
- Certifikatën mbi dënimet penale.

Sqarim: Vendqëndrimi për automjete taksi për persona juridik sigurohet nga vetë operatorët.

Aplikacionet merren në zyrën e Drejtoratit për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim.

Afati i aplikimit është 15 ditë prej datës së publikimit.

Nr. 13-111/01-15513

Lipjan, datë 07-04.2025

Drejtori i DSHPMSh-së
Burim Rrustemi

